

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ "Shqipëria tani është një adresë ku bota troket" - Rama me diasporën në Michigan: Nuk jemi më vend mbijetese, por vend shprese! Objektivi ynë, BE në 2030
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/shqiperia-tani-eshte-nje-adrese-ku-bota-troket-rama-me-diasporen-ne-mic-i587357
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 23:51:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 22:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	694f5b305d74968faa392956a183b246e28682ede84cc51af9fc46a332280b75
TEKSTI	10c51dd0ec66471e25d4b5d7c1c0b95e0a8dbc385c2f9e6dc9add2d6d9a0492f
PAMJA	ae7a77205819ab6300078e992db119c34716f9887531a5d9793ddbfb856d74dc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b9082092aacf67350cb5bb83ef18a9f7da7682a0fbf7a5708cb638fd81fad193
E MËPARSHMJA	930987c12212c601043a49a01355a87901b3fa8ffaa4f25023890fac98650895
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b9082092aacf67350cb5bb83ef18a9f7da7682a0fbf7a5708cb638fd81fad193>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



VIDEO/ Rama me diasporën në SHBA: Ambasadorët me të mirë janë shqiptarët që i ngrejnë emrin Shqiperisë VIDEO/ "Shqipëria tani është një adresë ku bota troket" - Rama fundit

VIDEO/ "Shqipëria tani është një adresë ku bota troket" - Rama me diasporën në Michigan: Nuk jemi më vend mbijetese, por vend shprese! Objektivi ynë, BE në 2030



21 Shtator 2026, 00:55 Politika TEMA

Kryeministri Edi Rama e nisi vizitën e tij në Shtetet e Bashkuara me një takim me komunitetin shqiptar në Michigan, përpara angazhimeve në kuadër të javës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.



Kryeministri e nisi fjalën e tij duke sjellë në vëmendje një fakt simbolik nga Michigan-i, ku, siç tregoi ai, disa vite më parë ishte regjistruar për herë të parë një flamingo si vizitor. Duke e lidhur këtë edhe me debatin që flamingot kanë nxitur në Shqipëri në lidhje me mjedisin, ekonominë dhe zhvillimin, Rama tha se kjo tregon një ndryshim të vetë shoqërisë shqiptare.

Sipas tij, shqiptarët nuk jetojnë më me logjikën e vjetër se "ka dhe më keq", por gjithnjë e më shumë kërkojnë që gjërat të bëhen më mirë.

"Shqiptarët sot jetojnë me idenë se tani ka dhe më mirë", tha Rama, duke shtuar se kjo, sipas tij, është pjesë e "Shqipërisë së re".

Një pjesë të veçantë të fjalimit kryeministri ia kushtoi diasporës. Ai e përshkroi diasporën e deridjeshme si "një det të madh energjie", por pa mekanizma të mjaftueshëm për të kanalizuar mundësitë dhe kontributet e saj.



Sipas kryeministrit, marrëdhënia mes emigracionit shqiptar dhe vendit ka ndryshuar krahas transformimit ekonomik të Shqipërisë.

"Tani ju në Shqipëri nuk dërgoni më para për bukë apo për ilaçe, për mbijetesë. 90 për qind e familjeve kanë përfituar këto 35 vjet së paku një herë nga diaspora shqiptare. Tani ne nuk jemi një vend mbijetese, por një vend shprese", u shpreh ai.

Rama shtoi ndër të tjera se diaspora nuk duhet të shihet thjesht si një burim remitancash.

"Diaspora nuk është një llogari bankare e atdheut, por është një rrjet i madh njerëzish që mbajnë sytë nga atdheu", tha kryeministri.





Ai përmendi votën e diasporës në zgjedhjet e fundit dhe tha se tashmë po ndërtohet një strategji më e gjerë në kuadër të "Shqipërisë 2030", me diasporën në qendër të saj.

"Tani kemi një strategji më të gjerë të Shqipërisë 2030, e cila e ka në qendër të vëmendjes diasporën. Ne po krijojmë Regjistrin Kombëtar të Diasporës, që do të jetë një dritare unike për t'u lidhur me Shqipërinë", deklaroi Rama.

Sipas tij, shqiptarët jashtë vendit janë edhe një lloj matësi i ndryshimit të Shqipërisë, pasi e shohin vendin me një distancë tjetër.

"Ajo e shikon ndryshimin më mirë, më qartë, pasi ajo nuk jeton me kantierin, por me rezultatin", tha Rama.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit, në afërsi të hotelit ku mbahej takimi, një grup prej rreth 20 personash protestoi në distancë.





Ata mbanin pankarta dhe hodhën thirrje mes të cilave “Rama në burg” dhe “Berisha në burg”. Protesta u zhvillua pa incidente.



Në vijim të fjalës së tij, Rama u ndal edhe te vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Ai tha se Shqipëria nuk mund të bëjë më shumë sesa t'i qëndrojë në krah Kosovës, ndërsa theksoi se vetë institucionet e Kosovës duhet të përcaktojnë mënyrën se si do të reagojnë ndaj vendimit.

“Shqipëria s'mund të bëjë asgjë më shumë sesa t'i rrijë në krah Kosovës, por ata duhet të vendosin të bëjmë gjithçka për ta zhbërë atë vendim kundër atyre katër burrave”, tha Rama.

Kryeministri dha gjithashtu një lajm të rëndësishëm për shqiptarët e Michigan-it, duke njoftuar se qeveria është gati të hapë një konsullatë shqiptare në këtë shtet.

“Shqipëria duhet të jetë pranë jush sa herë keni nevojë për të. Shqipëria ka një derë tani kur ju të keni nevojë për çështje konsullore”, shtoi Rama.

Kryeministri foli edhe për zhvillimin e transportit ajror, duke thënë se aeroporti i Tiranës ka ritmin më të lartë të rritjes në rajon dhe se ka lënë pas Beogradin për numrin e pasagjerëve.

“Ne jemi vendi me aeroportin me rritjen më të madhe në rajon dhe njërin me më të lartët të pasagjerëve, duke lënë pas Beogradin që për një shekull ka qenë aeroporti më i madh i Ballkanit”, tha ai.

Në fjalën e tij, Rama u ndal edhe te procesi i integritetit evropian, duke deklaruar se Shqipëria ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave dhe po hyn në fazën e mbylljes së tyre.

“Shqipëria është në fazën që ka hapur gjithë kapitujt dhe po hyn në fazën e mbylljes së tyre, që më 2030 të mbarojë kapitulli i hyrjes në BE”, tha kryeministri.

Ai përmendi gjithashtu organizimin në Shqipëri të samitit të ardhshëm të NATO-s, duke e paraqitur këtë si një tregues të ndryshimit të rolit ndërkombëtar të vendit.

“Shqipëria tani është një adresë ku bota troket për të diskutuar të ardhmen e saj”, tha Rama.

Takimi pati edhe një moment simbolik në fund, kur fëmijët e shkollës shqipe në Michigan i dhuruan kryeministrit një punim të përgatitur posaçërisht për të. Në të shkruhej dedikimi “Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama”, i rrethuar nga emrat dhe firmat e fëmijëve. Disa prej tyre kishin veshur edhe kostume tradicionale shqiptare.



 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.